

VENDIM
Nr. 927, datë 29.12.2014

PËR KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË BAZËS SË VLERËSUAR PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, paragrafi i dytë, e 59, pika “1”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, për llogaritjen fillestare të pensioneve, me datë fillimi 1.1.2015 dhe në vazhdim, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për pagat referuese,	deri m 1.1.1994	8.59
Për pagat e vitit	1994	8.59
Për pagat e vitit	1995	6.92
Për pagat e vitit	1996	5.37
Për pagat e vitit	1997	5.37
Për pagat e vitit	1998	4.48
Për pagat e vitit	1999	3.64
Për pagat e vitit	2000	3.31
Për pagat e vitit	2001	2.83
Për pagat e vitit	2002	2.62
Për pagat e vitit	2003	2.34
Për pagat e vitit	2004	2.13
Për pagat e vitit	2005	1.93
Për pagat e vitit	2006	1.76
Për pagat e vitit	2007	1.67
Për pagat e vitit	2008	1.48
Për pagat e vitit	2009	1.36
Për pagat e vitit	2010	1.30
Për pagat e vitit	2011	1.25
Për pagat e vitit	2012	1.20
Për pagat e vitit	2013	1.16
Për pagat e vitit	2014	1.00

2. Në vitin 2015 dhe në vazhdim, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, pas indeksimit të tyre vit pas viti, me koeficientët vjetorë të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

a) trefishi i pagës minimale të indeksuar, të vitit përkatës, për pagat nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale, e përcaktuar për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore në vitin 2014 e në vazhdim, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2015 e në vazhdim dhe përballohen brenda buxheteve vjetore, të miratuara për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

4. Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuar në vendimin nr. 582, datë 17.7.2013, të

Këshillit të Ministrave, mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet, vetëm për pensionet me datë fillimi deri në 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama